



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. ____ prot.

Gramsh, më ____/____/2023

Lloji i diplomës: “Shkencat Sociale”
Niveli minimal i diplomës: “Master Shkencor”

SHPALLJE PER VEND TE LIRË PUNE

(me kohë të pjesshme , për 25 ditë)

“Trajnues për dhënien e trajnimeve për të mbështetur Bashkinë Gramsh në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social me fokus fëmijët dhe fuqizimin e familjes.”

Në zbatim të projektit “Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuar në familje dhe në Qendrën Ditore”, të Drejtorisë së Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara, pranë Ministrisë së Shëndetësis dhe Mbrojtjes Sociale; Shkresës nr.6717, datë 04.07.2023 “Akordimi i fondeve për financim në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel Qarku dhe Bashkie”, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Bashkia Gramsh po kërkon të kontraktojë dy ekspertë për të rritur kapacitetet e stafit të Bashkisë përmes zhvillimit të trajnimeve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social me fokus fëmijët dhe fuqizimin e familjes, në kuadër të projektit "Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me Aftësi të Kufizuar në familje dhe në Qendrën ditore "Lulet e Diellit" financuar nga Fondi Social (MSHMS) dhe implementuar në bashkëpunim me Fondacionin Joscelyn.

Rreth projektit

Në përputhje me Ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë" shërbimet e kujdesit social janë një sistemi integruar dhe i organizuar i përfitimeve dhe lehtësirave të ofruara nga profesionistët në fushat përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim garantimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes sociale të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes social.

Në përputhje me ligjin për shërbimet e kujdesit social, ligjin e decentralizimit, por edhe organikisht të lidhur me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, ligjin përmasat kundër dhunës në familje, njësitë të administratës lokale dhe komunave u jepet përgjegjësi për të hartuar dhe

menaxhues këto shërbime në përputhje me nevojat dhe karakteristikat specifike të komuniteteve sipas vendndodhjes duke përdorur një qasje të menaxhimit të çështjeve. Në këtë kontekst Bashkia Gramsh në partneritet me fondacionin Joscelyn ka nisur implementimin e projektit “Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me aftësitë Kufizuar në familje dhe në Qendrën ditore” në financimet e Fondit Social dhe në nga ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Qëllimi i këtij shërbimi është të hartojë dhe ofrojë një set trajnimesh për stafin e angazhuar në këtë projekt gjatë periudhës Nëntor/Dhjetor 2023.

Objektivi i trajnimeve

Ngritja e kapaciteteve për profesionistët që synojnë të ndërtojnë njohuri dhe të përmirësojnë efikasitetin e reagimittësistemit të kujdesit social ndaj komuniteteve vulnerabël.

Përvoja dhe aftësitë e kërkuara/të preferuara të Ofruesve të Shërbimit:

Trajnerët të kenë kualifikimin e nevojshëm për ofrimin e trajnimit teknik. Preferohen me eksperience pune në shërbimin social dhe atë psikologjik. Mundësisht kualifikim të nivelit mastër ose doktoraturë (CV & Dokumentet Mbështetëse)

- Trajnuesit duhet të kenë aftësinë për t'u përshtatur sipas kontekstit dhe nevojave.
- Trajnerët duhet të kenë aftësi shumë të mira teknike dhe drejtuese.
- Trajnerët duhet të kenë përvojë të mëparshme pune
- Trajnuesi duhet të kenë njohuri shumë të mira mbi politikën dhe legjislacionin e zhvillimit në lidhje me arsimin për fëmijët, shërbimet sociale, ndihmën ekonomike për grupet vulnerabël shërbimet shëndetësore, punësimi dhe buxhetimi me pjesëmarrje.
- Përvoja e mëparshme në shërbime konsulence;
- Ekipet duhet të kenë metodologji të konsultimit të erriturve;
- Aftësia për të përmbushur afatet dhe për të ruajtur cilësinë e lartë të prodhimit duke punuar nën presion dhe kufizime kohore;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi / organizative, vëmendje ndaj detajeve;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi me shkrim dhe me gojë;
- Përvojë në shkrimin e raportit.

Përgjegjësitë e trajnerëve të kontraktuar

Trajneri duhet të sigurojë një plan të detajuar të zbatimit, i cili do të konsultohet dhe

rënë dakord me menaxherin e projektit

Të dizenojnë metodologjinë dhe materialet e trajnimit sipas udhëzuesit lehtësues të përfshirë këtu në funksion të objektivave të përkthyer më sipër;

Guide Lehtësimi për trajnimet

Kryerjen e trajnimeve në zonat ku po zbatohet projekti.

Të përgatisin një raport përfundimtar, ku komentet, sugjerimet pasqyrohen në marrëveshje me organizatën partnere.

Tematikat

Ky program i ndërtimit të kapaciteteve do të shqyrtojë tematikat :

- Sfidat me të cilat përballen familjet vulnerabël
- Konceptualizim i forcimit të familjes
- Lidhjet midis menaxhimit të rasteve dhe forcimit të familjes
- Lidhjet midis shëndetit mendor/mbështetjes psiko-sociale dhe forcimit të familjes
- Lidhjet midis shërbimeve të shëndetit publik dhe forcimit të familjes
- Standarde specifike për t'u marrë parasysh nga punonjësit sociale
- Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje
- Procedurat dhe format e kujdesit alternative
- Shërbimet sociale dhe roli i punonjësit social për rastet me AK
- Teoritë dhe shkaktarët e nevojave të veçanta. Paaftësia intelektuale
- Vështirësitë në komunikim dhe të folur. Adhd
- Çrregullimi i Spektrit të Autizmit. Çrregullimet e të nxënësve

Aktivitetet kryesore në kohë :

ACTIVITETI	KOHA
<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i modulit të trajnimit mbi "Të punosh me familjet në vështirësi" duke përfshirë materialet teorike, PPP dhe para/pas testet 	1/5 nëntor
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillohen trajnime periodike mbi "Ofrimin e shërbimeve të kujdesit social me focus fëmijët dhe fuqizimin e familjes. • Sigurohen që të gjitha temat/sesionet e parashikuara në axhendë të mbulohen gjatë 25 ditëve të trajnimeve. 	Nentor /dhjetor 2023
<ul style="list-style-type: none"> • Dorëzimi I raportit mbi trajnimet e zhvilluara 	24 dhjetor 2023

Totali i ditëve të punës për 2 ekspert: 25 ditë pune

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Një dokument i qartë propozimi që shpjegon metodologjinë duke u fokusuar në mënyrën se si eksperti parashikon procesin e sugjeruar dhe ndarjen e ditëve të punës
- Një shprehje interesi për konsulencën që liston rëndësinë e kandidatit në pikëpamje të këtij pozicioni;
- CV që thekson ekspertizën e aplikantit në tema si punosh me familjet në vështirësi, ofrimin e shërbimeve të kujdesit social me focus fëmijët dhe fuqizimin e familjes angazhimi i komunitetit, korniza e politikave për shërbimet sociale etj.
- Tarifa e konsulencës në total duke përfshirë të gjitha taksat e aplikueshme.

Dokumentat të dorëzohen pranë Bashkisë Gramsh, deri më datë 23.11.2023.

Shpallur sot me 13.11.2023

K R Y E T A R I

BESION AJAZI

